



Thirrje për shprehje të interesimit për partneritet

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë nga shtatori i vitit 2019 ka filluar zbatimin e projektin regional “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja (YEPP)”, projekt i financuar Nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ).

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë së bashku me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni dhe Serbi si dhe Herman Gmeiner Fund Development (HGFD) është në procesin e aplikimit për fazën e dytë të projektit regional “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja (YEPP2)” dhe është në kërkim të partneritetit me OJQ-të tjera vendore të cilat në fushëveprimin e tyre e kanë edhe punën me të rinjtë të marginalizuar.

Me qëllim të finalizimit të procesit të aplikimit tek BMZ, SOS Fshatrat e Fëmijëve ka hapur thirrjen për shprehje të interesimit për partneritet për OJQ -të vendore cilat veprojnë në: Prizren, Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj, të cilat veç tjerash në fokus të punës së tyre kanë të rinjtë e marginalizuar dhe punësimin e tyre.

Përzgjedhja e OJQ-ve partnere në këtë fazë do të nënkuptoj që organizata është përzgjedhur si partnere potenciale për aplikim për projektin rajonal “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja 2 (YEPP 2) dhe jo domosdoshmërisht nënkupton që SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ka obligime ndaj organizatës partnere potenciale në rast se projekt propozimi rajonal nuk aprovet nga donatori apo në rast se donatori nuk e aprovon OJQ-në partnere të përzgjedhur nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë.

Partneriteti me OJQ-të e përzgjedhura për aplikim, nëse donatori (BMZ) aprovon projekt propozimin regional synohet të jetë prej 24 deri në 30 muaj dhe vlera dhe buxheti i kërkuar nga donatori për organizatat partnere potenciale do të jetë nga 55,000€ - 75,000€. Megjithatë buxheti përfundimtar për organizatat partnere do të përcaktohet në një fazë të mëvonshme

Objektivat e thirrjes për shprehje të interesimit

Qëllim kryesor i thirrjes për shprehje të interesimit me të cilat do të aplikohet në projektin regional Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja (YEPP2)” janë:

Të rinjtë e marginalizuar janë fuqizuar dhe kanë përvetësuar njohuritë dhe shkathtësitë për integrim socio-ekonomik

Krijimi i një mjedisi i cili mundëson integrimin socio – ekonomik të të rinjve përmes adoptimit të politikave të përmirësuara dhe masave të ndërmarra në nivel nacional dhe lokal

Veç tjerash përmes këtij projekti synohet që të rinjtë e marginalizuar të jenë të integruar më mire në tregun e punës, të fuqizojë kapacitetet e akterëve publik dhe të ndërtojnë kapacitetet socio ekonomike për të rinjtë si dhe ndërtohen kapacitetet e OJQ-ve partnere.



KUSH MUND TË SHPREHË INTERESIMIN PËR PARTNERITET?

Organizatat joqeveritare vendore (OJQ) të regjistruara në Kosovë se paku 5 vite nga data e aplikimit dhe të cilat veprojnë në Prizren, Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj; (OJQ) të cilat fokus të punës së tyre e kanë të rinjtë e marginalizuar dhe punësimin e tyre.

Për shkak të fushëveprimit të gjerë të legjislacionit në fuqi në Kosovë për regjistrimin e OJQ-ve, klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore ose organizatat fetare që janë të regjistruara si OJQ, nuk janë synim i thirrjes për partneritet.

Shprehja e interesimit

Organizatat joqeveritare vendore (OJQ) të cilat veprojnë të Prizren, Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj mund ta shprehin interesimin e tyre për partneritet duke dërguar në email adresen info@soskosova.org dokumentet në vijim:

Rezyme të organizatës dhe qytetin në të cilin veprojnë OJQ (formatin e rezumesë se organizatës mund ta shkarkoni në këtë link:)

- ▶ Certifikatën e regjistrimit në Kosovë;
- ▶ Statutin e organizatës
- ▶

Thirrja për partneritet është e hapur deri me datën **04 tetor 2022**

Çfarëdo pyetje që mund të keni rreth shprehjes së interesimit për partneritet mund të na shkruani në emailin info@soskosova.org.

Përzgjedhja e Organizatave joqeveritare vendore (OJQ) partnere

Pas pranimit të shprehjes së interesimit nga organizatat, SOS Fshatrat e Fëmijëve do të vizitoj organizatat të cilat kanë shprehur interesimin për partneritet dhe do të bëj vlerësimin programor, organizativ, financiar dhe të kapaciteteve të organizatave lokale.

Përzgjedhja e OJQ-ve partnere për aplikim për projektin “ Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja (YEEP2)” do të bëhet bazuar në përvojën e OJQ-ve me të rinjtë e marginalizuar dhe punësimin e tyre, zbatim të projekteve, dhe rezultateve të vlerësimit programor, financiar dhe të kapaciteteve të organizatës.

Për secilin qytet do të përzgjidhet një OJQ dhe të gjitha organizatat do të njoftohen përmes emailit.

Pas njoftimit OJQ-ve të përzgjedhura do të ju kërkohet të plotësojnë projekt propozimin dhe formën e buxhetit